Numër: 01/559
Datë: 07.09.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Pezullohet** kërkesa për hyrje në procesin e akreditimit e institucionit autoshkolla Qendra Nr.02/245 e datës 17.05.2022 e parashtruar nga Lavdim Hamiti - Autoshkolla Qendra, deri në njoftimin për përfundimin e hetimeve nga institucionet përgjegjëse.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni Autoshkolla "Qendra", me adresë: Ilaz Kodra, Nr.97, në Komunën e Prishtinë, përmes shkresës Nr.02/245 të datës 17.05.2022 ka aplikuar në AKK, për akreditim dhe validim të kualifikimit: Instruktor i vozitjes.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), me datë 22.02.2022 nxjerr vendimin Nr.01/45, përmes të cilit e ka refuzuar aplikacionin e institucionit autoshkolla Qendra.

Institucioni Autoshkolla "Qendra" vendimin Nr.01/45, të datës 22.02.2022 të Këshillit Drejtues të AKK-së e ka pranuar me datë 23.02.2022.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.01/45 të datës 22.02.2022 të Këshillit Drejtues të AKK-së, me datë 04.03.2022 parashtron ankesën me numër protokolli Nr.01/81 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), me datë 01.04.2022 nxjerr vendimin Nr.01/164, përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e institucionit autoshkolla Qendra.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), me date 14.03.2022, përmes emailit ashqendra@gmail.com ka pranuar email/shkresë nga institucioni Autoshkolla Qendra, me adresë Rr. Ilaz Kodra, nr. 97, Prishtine, ku institucioni emailin ja ka drejtuar: Zyrës për Komunikim me Publikun - ZKM, Mentor Borovci - Drejtori i Zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Agon h. Gashi - Koordinator i zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe CC është vendosur znj. Arbërie Nagavci - Ministre e MASHTI.

Institucioni autoshkolla Qendra me datë 17.05.2022 përmes shkresës me Nr.02/245 ka aplikuar përsëri për të hyrë në procesin e akreditimit për kualifikimin instruktor i vozitjes.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Kërkesa Nr.01/432, e datës 21.08.2021, e autoshkolles qendra; Listë kontrolli për dokumentet e nevojshme për procesin e akreditimit dhe validimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP); Vendimi Nr.01/45, i datës 22.02.2022 i KD AKK; Ankesa Nr.01/81, e datës 04.03.2022 drejtuar KD AKK; Vendimi Nr.01/164, i datës 01.04.2022 i KD AKK; Emaili Nr.02/93, i datës 14.03.2022 i autoshkolles qendra drejtuar Mentor Borovci - Drejtori i Zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Agon h. Gashi - Koordinator i zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe cc është ber znj. Arbërie Nagavci - Ministre e MASHTI; Emaili zyrtar i datës 28.12.2021; Kërkesa Nr.02/110, e datës 15.03.2022, nga Drejtori i AKK për Policin e Republikës së Kosovës; Kërkesa Nr.01/432, e datës 21.08.2021 e autoshkolles qendra; Përgjigja Nr.02/95, e datës 14.03.2022 nga Drejtori i AKK për Zyrës për Komunikim me Publikun - ZKM, Mentor Borovci - Drejtori i Zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Agon h. Gashi - Koordinator i zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe cc është ber znj. Arbërie Nagavci - Ministre e MASHTI; Shkresa Nr.02/513, e datës 05.08.2022 e Policisë së Republikës së Kosovës lidhur me nisjen e hetimeve; Përgjigja e datës 10.08.2022 për Policin e Republikës së Kosovës nga Drejtori i AKK;

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore që kërkesa për hyrje në procesin e akreditimit të ***pezullohet, sepse:***

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, bazuar në këto rrethana dhe duke e vlerësuar që ankuesi me datë 13.03.2022 përmes emailit ashqendra@gmail.com ka pranuar email/shkresë nga institucioni Autoshkolla Qendra, me adresë Rr. Ilaz Kodra, nr. 97, Prishtine, ku institucioni emailin ja ka drejtuar: Zyrës për Komunikim me Publikun - ZKM, Mentor Borovci - Drejtori i Zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Agon h. Gashi - Koordinator i zyrës Ligjore në zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe cc është vendosur znj. Arbërie Nagavci - Ministre e MASHTI. Ne emalin/shkresën e Institucioni Autoshkolla Qendra pos tjerash edhe ka bëre akuza për ryshfet dhe ka shpif për zyrtaret e institucionit të AKK, në të cilën ka theksuar, citoj: *"Kjo për mua, jep me kuptua se, zyrtarët e këtij institucioni ku unë kam aplikuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë duan të më joshin që të jap ryshfet. Këtë e bazoj nga praktikat e të tjerëve të cilat i kam kuptuar, se si veprojnë këta zyrtar përmes një rrethi vicioz që e kanë krijuar. Kjo më bënë përshtypje dhe kam bindjen se vërtetë zyrtarët e këtij institucioni veprojnë në mënyrën e sipër theksuar. Unë si qytetar, nuk dua të largohem nga Kosova me fëmijët e mi, si rezultat i këtyre matrapazëve që fatkeqësisht dhe tragjikisht i kanë zaptuar vendet e punës pa merite"*. Institucioni Autoshkolla Qendra, akuzon se zyrtaret e AKK në mënyrë të drejtpërdrejt kanë dashur që ta joshin institucioni në fjalë që të jep ryshfet, dhe se kjo është forma në të cilën këta zyrtar veprojnë edhe me institucionet tjera. Në emalin e theksuar më lartë dhe të bashkangjitur me dokumente, ky institucion i quan nëpunësit e AKK me terme fyese dhe denigruese, siç janë: *"matrapaz, joprofesional dhe se vendet e punës i kanë uzurpuar dhe i kanë pa merite"*.

Policia e Republikës së Kosovës përmes shkresës Nr. i referencës: DHKEK-160/2022 e ka njoftuar AKK se është duke zhvilluar veprime hetimore në bazë të informatës së pranuar, rrjedhimisht nga kjo duke marrë për bazë dispozitat e nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, pas përfundimit të hetimeve nga institucionet e hetuesisë, do të shqyrtoj kërkesën Nr.02/245, të datës 17.05.2022 të institucionit autoshkolla qendra për të hyrë në procesin e akreditimit, kështu që deri në përfundimin e hetimeve KD I AKK e pezullon shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesës së

lartcekur. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit autoshkolla Qendra, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK